


23.01.2024
pramor



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

Nr.10/KA-001/24

Datë:19.01.2024

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të ankueseve kundër vendimit të Inspektorit Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor pranë MSH-së, në përbërje të: Dr. Shaban Osmanaj, Kryesues, Znj. Fjolla Shabani, anëtarë, Dr. Fakte Hoxha Haziri, anëtare, në bazë të Vendimit të Ministrit të Shëndetësisë me numër protokolli 05-2015 të datës 31.03.2023, duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Inspektoratin Shëndetësor nr. 02/L-038 dhe Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L-125, ka shqyrtuar ankesën me nr protokolli 05-2277/2 të datës 06.11.2023 dhe nr. 05-65 të datës 18.01.2024 të parashtruar nga z. Kastriot Asllani, Drejtor i Përgjithshëm i Kosova Med Health Care SH.P.K, ndaj vendimit të inspektorit shëndetësor me nr. 05-2227 të datës 27.10.2023. Në seancën e mbajtur të datës 19/01/2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa me nr. protokolli 05-2277/2 të datës 06.11.2023 të parashtruar nga z. Kastriot Asllani, Drejtor i Përgjithshëm i Kosova "Med Health Care" Sh.P.K me seli në Prishtinë
- II. **Anulohet** vendimi i inspektoratit shëndetësor me nr. protokolli 05-2227 të datës 27.10.2023.

Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të ankueseve kundër vendimit të Inspektorit Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor pranë MSh-së, ka shqyrtuar ankesën e parashtruar brenda afatit ligjor nga z. Kastriot Asllani, Drejtor i Përgjithshëm i Kosova Med Health Care SH.P.K, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, me kërkesë që të anulohet vendimi nr.05-2227 dt. 27.10.2023 i Inspektorit Shëndetësor dhe e njëjta të lirohet nga denimi i shqiptuar në shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro.

Me vendimin e ankimuar me nr. 05-2227 dt. 27.10.2023, ankuesit i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore deri në licencim nga Ministria e Shëndetësisë, për shkelje të

dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro.

Nga se, gjatë inspektimit të realizuar me datën 11.10.2023, në QKMF "Hafir Shala" në Drenas Inspektori Shëndetësor, si që ka përshkruar në Procesverbalin me nr. 01251 dhe procesverbalin me nr. 02450 (inspektim i kryer me datë 17.10.2023 në "KosovaMed Health Care" SH.P.K. Prishtinë, ku nga inspektorët e rastit ishte konstatuar se nuk ofrohet shërbim shëndetësor në këtë objekt) në kohën e inspektimit kanë hasur në personel shëndetësor të cilët nuk janë punëtor shëndetësor të QKMF-së së lartcekur, por të cilën kishin paraqitur provë se janë punëtor të kompanisë "Kosova Med Health Care" Sh.P.K. Prishtinë, të angazhuar me punë sipas Kontratës Publike Kornizë -shërbime nr.611-21-2552-2-1-1/C430 (Kujdesi social shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Drenasit) të dt. 18.06.2021, kontratë kjo e lidhur ndemjet Komunës së Drenasit nga njëra anë dhe "KosovaMed Health Care" SH.P.K. Prishtinë, në anën tjetër e cila nuk kishte licencë valide të punës së institucionit shëndetësor të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në arsyetimin e vendimit të ankimuar thuhet se gjatë inspektimit të datës 17.10.2023 në SPSH "KosovaMed HealthCare" SH.P.K. në Prishtinë, u konstatua se ky subjekt nuk kishte licencë valide të punës së institucionit shëndetësor të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe se ky subjekt merret me shitjen e aparaturave mjekësore dhe në kuadër të këtij subjekti janë të punësuar profesionist shëndetësor si Doktor të Mjekësisë, Stomatologjisë, infermier të cilët ofrojnë shërbime shëndetësore në hapësirat e QKMF-se Dr. Hafir Shala në Drenas.

Inspektori Shëndetësor vendimin e ankimuar e ka bazuar në paragrafin 1 të nenit 42 të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, i cili përcakton kushtet të cilat duhet përmbushur institucioni shëndetësor për Licencim dhe Akreditim, si dhe nën paragrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 94 të ligjit 04/L-125 për Shëndetësi i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 08/L-043 i cili ka përcaktuar se "Me gjobë në shumë prej një mijë (1,000) e deri në njëzet mijë (20,000) euro dënohet për kundërvajtje institucioni shëndetësor nëse ushtron kujdes shëndetësor pa përmbushur kushtet e parapara me nenin 40 dhe 42 të ligjit".

Pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga përfaqësuesi i kompanisë "KosovaMed Health Care" SH.P.K. me seli në Prishtinë, dhe administrimit të provave, që janë: Certifikata e Regjistrimit të Biznesit të "KosovaMed Health Care" sh.p.k. të lëshuar nga ARBK, licencat e stafit shëndetësorë të angazhuar nga "Kosova Med Health Care" SH.P.K. Prishtinë, në QKMF, Drenas, Kontratën Kornizë me QKMF, Drenas. Komisioni për Shqyrtimin e Ankuesëve ka konstatuar se "KosovaMed Health Care" SH.P.K. Prishtinë, është kompani tregtare e licencuar nga AKPM për shitëblerjen e pajisjeve medicinale dhe ofrim të kuadrove profesional medicinal në institucione shëndetësore të licencuara. Prandaj shkelja e konstatuara nga Inspektori Shëndetësor për mungesë të licencë valide të punës së institucionit shëndetësor të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, është i gabuar dhe e pa bazuar, nga se kompania "KosovaMed Health Care" SH.P.K. Prishtinë, nuk është Institucion Shëndetësor, dhe se nuk ofron shërbime shëndetësore në selinë e saj dhe as në ndonjë objekt tjetër të e sajë, e cila në këtë rast sipas kontratës ka angazhuar

staf profesional shëndetësor e të licencuar, në QKMF në Drenas, gjë që angazhimet e tilla parashihen me nenin 18 par. 11 të Ligji për Shëndetësi 04/L-125, "me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare".

Mbi këtë bazë Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave konsideron se vendimi i ankimuar i Inspektoratit Shëndetësor është nxjerrë mbi konstatimet e gabuara të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Andaj Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj kontest administrativ brenda 30 ditë pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ.

Ky Vendim lëshohet në 3 (tre) ekzemplarë origjinal.

Vendimi i dorëzohet:

1. Z. Kastriot Asllani, "KosovaMed Health Care" rruga Ndue Perleshi K.P. lokali nr. 1 - Prishtinë
2. Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë
3. Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm, MSh-së
4. Dr. Nora Kursani Demjaha, Zëvendësues i Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor
5. Arkivit të Inspektoratit Shëndetësor dhe Farmaceutik Nr. 2

Dr. Shaban Osmanaj,
Kryesues i Komisionit

